REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË
NR—340—REP
NR—166—KOL

Taksa e pullës u pagua

# PROKURË E POSAÇME

—*Në bazë të nenit 70 e vijuesa të K.Civil*—

Sot më datë 22 shkurt 2017 (dymijë e shtatëmbëdhjetë), ditën e mërkurë para meje **Noterit SOKOL SH MALAJ,** Noter pranë Dhomës së Noterisë Tiranë me seli në Rr." L.Gurakuqi", Pallati "ALBSIG" u paraqit personalisht:—

**Z. ILIR LATIFI** i biri i Mujo dhe Hava lindur në Pukë më 14/10/1978 banues në Tiranë, Rr"Iliria" Kamëz i identifikuar me pasaportën Britanike #651829672# aktualisht përdorues i telefonit Nr 00355682012100, Ortak i Vetëm/ Administrator i shoqërisë **"GREEN STEP" shpk**, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i cili pasi u sqarua për pasojat juridike që sjell ky Akt-Noterial, deklaroi sa vijon:—

"Emëroj Përfaqësues të posaçëm, **Z. ILIR KADIU,** i biri i Xhelal dhe Vangjeli lindur në Durrës më 20/01/1977 banues në Tiranë, Rr"A Lenja" Pall."Eridanus" i identifikuar me kartën e identitetit #024507240# me Nr.personal H70120195T madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i cili ka të drejta dhe kompetenca të plota të kryejë në emër dhe për llogari të aktivitetit tim privat, të shoqërisë **"GREEN STEP" shpk**, **pra veprimet ligjore pranë "QKB" për regjistrimin e kësaj Shoqërie**; por dhe pranë Organeve tatimore, për likujdimin e detyrimeve që unë kam ndaj organeve tatimore apo personave të ndryshëm publik.—

Për këtë qëllim përfaqësuesi i caktuar prej meje ka të drejtën të paraqitet pranë organeve shtetërore të dorëzojë dhe të terheqë çdo akt të nevojshëm si dhe të kryejë likujdimin e çdo detyrimi që kam ndaj shtetit.—

AI, ka të drejtën të nënshkruajë në mënyrën e përcaktuar më sipër, akte noteriale që lidhen me mbarë-funksionimin e aktivitetit tim privat. Për këtë qëllim unë vë në dispozicion të përfaqësuesit dokumentet e nevojshme të aktivitetit.—

Veç sa më sipër, AI ka të drejta dhe kompetenca të plota që të paraqitet në çdo organ të administratës shtetërore, në organet e tatim Taksave, vendore dhe/apo Qendrore, apo dhe pranë institucioneve private për të kryer veprime që kanë lidhje me aktivitetin tim privat; pra të shoqërisë **"GREEN STEP" shpk**, të cilën e përfaqësoj e ku jam ortak i vetëm.—

Përfaqësuesi im ligjor ka të drejta dhe kompetenca të plota ligjore që të paraqitet në çdo organ të Administratës Shtetërore, për të tërhequr dhe / apo dorëzuar dokumente që kanë lidhje me aktivitetin tim privat, si në zyrën e QKB(ish QKR), Arkivën e Shtetit, në atë të Noterisë, dhe në çdo institucion privat apo

shtetëror, që ka lidhje me tërheqjen dhe/apo dorëzimin e dokumenteve që kanë lidhje me aktivitetin tim privat të shoqërisë **"GREEN STEP" shpk**.—

Veç sa sipër përfaqësuesi im ka të drejtë të nënshkruajë Akt-marrëveshje të ndryshme, kontratë qiraje, punësimi e çdo akt tjetër noterial, lidhur me funksionimin sa më suksesshëm me atë individ dhe/apo shoqëri që ai do çmojë si më të favorshmin për interesin tim/tonë.—

Ai në emër dhe për llogarinë time, ka të drejta dhe kompetenca të plota e të pakufizuara, të kryejë të gjitha veprimet ligjore bankare pranë Bankave ku shoqëria që unë përfaqësoj ka numra llogarie të hapura. —

***Lidhur me sa më sipër, Përfaqësuesi i emëruar prej meje me anë të kësaj Prokure të Posaçme të hartuar me vullnetin tim të lirë e të plotë në Zyrën e Noterisë Tiranë, ka të drejtën të kryejë çdo transaksion Bankar në Numrat e Llogarisë, në të gjitha mënyrat e parashikuara nga ligji, pra të derdhë, të transferojë në emër të të tretëve si dhe të tërheqë-sipas kërkesave/nevojave, mbylljen apo dhe në hapjen e kontove të reja Bankare pranë asaj Banke që do çmohet prej tij se është në interesin tim.—***

Pra, Përfaqësuesi im ka të drejta të plota e të pakufizuara të paraqitet pranë sporteleve të këtyre Institucioneve Bankare, për të proçeduar në lidhje me kryerjen e të gjitha veprimeve që përmenden në këtë akt.—

Veç sa më sipër, Ai ka të drejta dhe kompetenca të plota që të paraqitet edhe në çdo organ të administratës shtetërore apo dhe pranë institucioneve private për të kryer veprime që kanë lidhje me aktivitetin tim privat si dhe për të dorëzuar dhe/apo për të tërhequr dokumenta të miat personale apo si shpk e për të kryer edhe çdo pagesë.—

Në **rast mosmarrëveshje** ***Ai ose Avokati/Përfaqësuesi i caktuar prej tij***, ka të drejtën të ndjekë zgjidhjen e saj në rrugë gjyqësore dhe administrative, në të gjitha instancat gjyqësore, të paraqesë çdo lloj padie, pranë Gjykatës përkatëse të Rr.Gjyqësor/Administrative, kundërpadie, ndërhyrje kryesore, dytësore si dhe çdo lloj kërkese, duke i nënshkruar ato në emër dhe për llogarinë time duke u paraqitur me çdo cilësi ndërgjyqësi dhe të disponojë mbi objektin e padisë duke patur të drejtën të shtojë, pakësojë, ndryshojë objektin e Padive, kundërpadive, kërkesa të ndryshme duke i nënshkruar në emrin dhe për llogarinë time me qëllim mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave pasurore.—

Përfaqësuesi ka të drejtën të bëjë pretendime, prapësime, të paraqesë prova shkresore, të thërrasë apo të përjashtojë dëshmitarë, të kërkojë thërritjen apo përjashtimin e ekspertëve, përfshi edhe kërkesat drejtuar gjykatës për marrjen e çdo lloj vendimi të ndërmjetëm, të hartojë dhe nënshkruajë ankime në Gjykatën e Apelit, Rekurs në Gjykatën e Lartë, të hartojë dhe nënshkruajë kërkesë për ekzekutimin e vendimit dhe lëshimin e Urdhërit të Ekzekutimit.—

Përfaqësuesi i caktuar prej meje ka të drejtë të kërkojë nga gjykata, kryerjen e çdo veprimi proçedurial të parashikuar në ligje që sqaron rrethanat e çështjes e pretendimet e mia.—

Veç sa sipër, përfaqësuesi im ka të drejtën të ndjekë çdo proçedurë të nevojshme lidhur me mbarëvajtjen e aktivitetit tim, pavarësisht faktit që nuk përmendet në këtë Prokurë, *duke vepruar kurdoherë në mirebesim dhe në mbrojtje të interesit tim*, por duke përjashtuar veprime bankare kredi/huamarrëse në emër tim apo të aktivitetit tregëtar pra tëshoqërisë **"GREEN STEP" shpk** -për të cilin jam liçensuar/regjistruar, si dhe duke përjashtuar të drejtën e tjetërsimit të kuotës sime të pronësisë, në asnjë nga mënyrat e parashikuara nga ligja, pra as të shesë, dhurojë, premtojë apo të rëndojë (kontratë hipotekimi për asetet).—

UNË të gjitha veprimet e tij, që lidhen me sa më sipër i konsideroj të drejta e të mirëqëna, me fuqi të plotë ligjore dhe të pa kontestueshme njëlloj, sikur të isha vetë prezente me anën e kësaj Prokure të Posaçme të hartuar me vullnetin tim të lirë e të plotë në zyrën e Noterisë Tiranë.—

Kjo prokurë është e vlefshme deri sa të revokohet në mënyrë të ligjshme nga porositësi dhe të komunikohet ligjërisht revokimi i saj në bazë të nenit **76 të K.Civil.**"—

Për të vërtetuar sa më sipër u hartua kjo Prokurë e Posaçme e cila si u lexua dhe u gjet sipas vullnetit të porositëses u nënshkrua sipas ligjit në praninë time dhe unë Noteri e vërtetoj atë rregullisht.—

**P O R O S I T Ë S I**
**Z. ILIR LATIFI**
Ortak i Vetëm/ Administrator i shoqërisë
**"GREEN STEP" shpk**

ILIR LATIFI

**N O T E R**
**S O K O L SH. M A L A J**

NOTER
SOKOL SH. MALAJ
RR.Luigj Gurakuqi P.2
TIRANE / ALBANIA
Tel. 00355 (4) 2229832
Cel. 00355 68 40 55564